



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 25.08.2025
Numër Protokolli: 5741/2025

A.nr.1601/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare; Eshref Shabani dhe Malsore Gashi, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar në çështjen juridike administrative sipas ankesës me numër A.nr.1601/2025, të datës 18.08.2025, të parashtruar nga ankuesi B.B, kundër organit të punësimit: Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.08.2025, mori këtë.

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1601/2025, të datës 15.08.2025, të parashtruar nga ankuesi B.B.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, B.B (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 15.08.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 01.07.2025, të Zyrës së Personelit në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, lidhur me refuzimin e aplikacionit për procedurën e pranimi sipas Konkursit me numër reference RN00017896, për Grupin e Inxhinierisë Minerare, gjegjësisht pozitën e punës “*Inspektor i Minierave*” në Departamentin e Inspektoratit në Prishtinë, ndërsa, i njëjti më datë 22.05.2025 ka parashtruar përmes e-mailit zyrtar (ankesa.kpmschck@rks-gov.net), ka parashtruar kërkesë e për tërheqje të ankesës me numër A.nr.1601/2025 të datës 15.08.2025, duke mos specifikuar arsyet e tërheqjes së ankesës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “*Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, vendosi për përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1601/2025, të datës 15.08.2025, pasi që nga kërkesa e datës 22.08.2025, rezulton se ankuesi nuk ka interes juridik që të vazhdoj me këtë procedurë administrative.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1601/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetarja e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, B.B;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.